

Kadare

DANTJA I PASHMANGSHËM
ose NJË HISTORI E SHKURTËR E SHQIPËRISË
ME DANTE ALIGIERIN

BIBLIOTEKA

BSH-4
K14

Onufri
BOTIME



8,5HL 4
K 14

ISMAIL KADARE

DANTJA I PASHMANGSHËM

ose

NJË HISTORI E SHKURTËR E SHQIPËRISË
ME DANTE ALIGIERIN

sprovë



Onufri

Planeti ynë është tepër i vogël për ta bërë të shmangshëm Dante Aligierin. Dantes nuk mund t'i iket, ashtu siç nuk i iket dot ndërgjegjes. Asnjë vepër tjetër letrare nuk e ka ndërgjegjen njerëzore, më saktë, krusmën e saj, në qendër të vet.

Në Evropë, në lagjen e madhe ku ndodhet Italia bashkë me Danten e vet (gjithaq mund të thuhet, Dantja me Italinë e vet), nuk ka njeri që të mos ia ketë dëgjuar emrin. Por ai të arrin sado larg të jesh, në SHBA, për shembull, në Rusi, Izrael, Japoni, Australi e Zelandën e Re. Edhe në qoftë se ka vise ku ai ende nuk është (njëfarë “nondanteland”, nëse

do të na lejohej një fjalë e tillë), kjo është e përkohshme.

T. S. Elioti ka shkruar, ndër të tjera, se këngët e Dantes “duhen lexuar si zgjerime të hapësirës rreptësisht të kufizuar njerëzore”.

Ngushtica e planetit tokësor ka qenë dhe mbetet një nga makthet e krijuesve të mëdhenj. Të gjithë ata përpiqen ta kapërcejnë atë dhe, në këtë synim drejt daljes, disa rrëzohen më afër e disa më larg. Dante Aligieri është ai që gjer më sot ka fluturuar më larg se të gjithë.

Mungesa e tokës, e truallit, e zotërimit të tij, e bëri që të krijojë një tjetër mbretëri, atë që nuk ia merrte dot askush e, prej së cilës nuk e dëbonin dot, ashtu siç e dëboi Firencia.

Ka gjasë që pikërisht Firencia të ketë qenë bërthama e ferrit të tij.

Ka gjasë që fill pas dëbimit, madje përpara tij, atëherë kur e ka parandier dëbimin, një ëndërr të jetë bërë shkas. Një ëndërr, nga ato që truri i njeriut di aq mirë t’i ndërtojë, me ngërçet e pafundme, ecën e nuk ecën dot, rrekesh t’i afrohesh diçkaje e s’mundesh, dhe ajri, dhe stuhia ndonëse lëvizin janë të vdekura, dhe trualli ashtu është si prej tymi, dhe asnjë shpresë prej askundi s’vjen.

Poeti rus, Osip Mandelshtam, që do të para-ndiente e, fill pas parandjenjës, do ta përjetonte

dëbimin, sipas dëshmisë së Anna Ahmatovës, një tjetër shtetase e ferrit sovjetik, ishte magjepsur pas Dantes, pikërisht në prag të tragjedisë së vet. Meqenëse Mandelshtami kishte nisur, ndërkaq, ta ndiente veten si në ferr, në të vetmen përsiatje që shkroi për Danten, nënvizoi antigjeografinë e ferrit dantesk. Për të, ferri, ashtu si epidemitë, si lia e zezë apo murtaja, s'kishte hapësirë përmbyllëse. Gjithmonë sipas tij, rrathët e ferrit për të dëbuarin janë gjithë qytetet ku ai s'ka të drejtë të hyjë. Qytetet italiane të Dantja, sipas përfytyrimit të Mandelshtamit, Piza, Firencia, Luka, Verona, u ngjanin njëherësh "unazave të internimit të Saturnit", rrathë të përbindshëm, që, në gjendje të tymtë, shtillen nëpër acar.

Ndërkaq, Firencia, ashtu si qytetet e tjera përreth, ishte e ngushtë për Danten. Në mbretërinë që po e zgjeronte ditë pas dite e natë pas nate, truri i tij futi pjesën më të madhe të botës. Dhe ky ishte vetëm fillimi.

Një nga gjërat e para që mësojmë për Danten është dëbimi i tij prej qytetit të vet. Kjo është pjesa e sipërme, e dukshme e historisë. Por, të gjendur përpara mbretërisë së re, me të cilën ai e zëvendësoi Firencën, më saktë, përpara tri mbretërive, Ferrit, Purgatorit dhe Parajsës, ne kemi të drejtë të shtrojmë pyetjen paradoksale: mos vallë, ndonëse

në mënyrë të pandërgjegjshme, me dashje, ai shkoi drejt humbjes së Firences?

Një pyetje e ngjashme mund të bëhej lidhur me gruan e re fiorentinase, Beatrice Portinarin, asaj që u tregua e kursyer me poetin, dhe që vdiq pastaj, në moshën 24 vjeçe, pa u bërë, siç thuhet, e tija.

Për shumë danteologë, një qytet dhe një grua, të dy të humbur, janë të muruar në themelet e më të lartës katedrale të poezisë, “Komedisë hyjnore”. Firencia lidhet me hapësirën, Beatriceja me kohën. Siç thotë Jorge Luis Borges, koha ose jeta për Danten ishte e dyllorshme: me ose pa Beatricen. Ai e humbi atë në Firence, e më pas, sipas ithtarëve të tij, s’bëri gjë tjetër veçse kërkoi një vend ku ta strehonte e të shihej me të: Parajsën. Dhe ne prapë kemi të drejtë të pyesim: mos vallë edhe për këtë këmbim të madh, ashtu si në rastin e Firences, ai, duke iu bindur një urdhri të fshehtë, shkoi vetë drejt humbjes?

Hapësira dhe koha janë si askund të pafundme në poemën e tij. Por ai do të shkonte edhe më larg. Adhuresit e tij, duke folur për gjeografinë danteske, do të theksonin se këto peizazhe të çuditshme “nuk janë vende, por gjendje shpirtërore”. Në të vërtetë, zanafilla e këtij komenti është një letër e famshme e vetë Dantes. Ai përmend pikërisht fjalën “gjendje” dhe ne mund

të shtojmë se të tri pjesët e poemës së tij, Ferri, Purgatori e Parajsa, janë “të tri gjendjet tona”, që ne i përjetojmë njëherazi, gjithmonë e gjithkund.

“I lindur për të gjithë dhe prej të gjithëve i rritur”. Kështu e ka quajtur, ndër të tjera, Saint-John Persi, në kremtimin e 700-vjetorit të tij.

Rrathë-rrathë, rrotull Dantes, shtillen qytetet e Italisë Veriore, ato unazat e frikshme të Saturnit, për të cilat flet Mandelshtami. Pastaj vinte gjithë Italia, fqinjët e saj, ishujt, gadishujt, dhe më pas, kontinenti evropian, e fill pas tij, gjithë bota. Njëra pas tjetrës unazat mbështillnin Romën, Berlinin, Lushnjën, Magadamin, Moskën, Burrelin, Budapestin, Aushvicin, Tiranën, Pragën, Babi Jarin, Kolimën.

Të gjitha këto vende, këta popuj e këto gjuhë, duan apo s'duan, kanë një lidhje, një raport me Danten, të tillë që pak a shumë vendoset me shenjëzat e palëvizshme në qiell. Thënë ndryshe, të gjithë kanë një histori me të.

Në këtë sprovë do të synohet të jepet një histori e shkurtër e marrëdhënieve të njërës prej fqinjeve më të afërta të Italisë, Shqipërisë së vogël me Dante Aligierin.

Endodhur përballë Shqipërisë, me të cilën nuk e ndan veç një det i ngushtë i përbashkët, Italia që njohim, Italia e rrokshme, ashtu sikurse shpirti i saj, Dantja, do të bëhej gjithashtu e pashmangshme për fqinjen e saj.

Kur Dante Aligieri po shkruante, në vetminë e mërgimit, "Komedinë hyjnore", në gadishullin ballkanik ishin shfaqur ca si personazhe të habitshme, që nuk ngjasonin si të kësaj bote. Siç doli më pas, këta endacakë nuk ishin veçse zbuluesit e parë të perandorisë osmane, e ata po kërkonin shtigjet më të përshtatshme për të sulmuar Evropën.

Në kohën kur pas vdekjes Dantja po bëhej përherë e më i shquar, gadishulli ballkanik ishte gjysmë i pushtuar ndërkaq, kurse Bizanti i famshëm, më shumë se një perandorie, i ngjante një robinje, që, ndonëse ende shtirej si mbretëreshë,

e kishte humbur ndërkaq gjithçka dhe s' ishte veçse një konkubinë e shtetit të stërmadh osman.

Kohë më pas, kur Bokaçio i mahnitur pas Dantes, titullit të poemës së tij "Komedia" i shtoi fjalën "hyjnore", një kont shqiptar, me emrin e dyzuar Gjergj Kastriot Skënderbeu, po bënte një përpjekje të fundit të dëshpëruar, për të ndaluar valën osmane. Duke kapërcyer shumë herë detin Adriatik, (i pashmangshmi i tretë në këtë histori), Gjergj Kastrioti udhëtoi shpesh në Venedik, e sidomos në Romë e në Napoli, për të bashkërenditur veprimet ushtarake me aleatët e vet përëndimorë, dukët e Venedikut, mbretin e Napolit e sidomos Papën e Romës. Ai i bëri këto rrugëtime herë i vetëm, e herë në krye të trupave ushtarake. Këto ishin trupa shqiptare, që merrnin pjesë në grindjet italiane ose ushtarë e oficerë italianë, që luftonin në Shqipëri kundër osmanëve. Është e kuptueshme që një pjesë e këtyre ushtarakëve nuk ktheheshin më në vendet e tyre. Sipas kronikave, vetëm në njërën nga betejat më tragjike, atë të Beratit, në Shqipëri, ushtarët dhe oficerët e vrarë italianë ishin rreth 5000 veta.

Gjergj Kastrioti komandoi kështu trupa të përbashkëta evropiane kundër një rreziku që kërcënonte kontinentin e krishterë, ndaj dhe mund të hyjë në radhët e gjeneralëve, hijet e të cilëve

përbëjnë spikamën e parë të parahistorisë së aleancës së ardhshme atlantike.

Fatkeqësisht, as titujt e shumtë që mori si “mbrojtës i Evropës” e “atlet i Krishtit”, as biografitë himnizuese, poemat, romanet, dramat e operat që u shkruan për të nga autorë të famshëm, si Ronsari, Lope de Vega, Longfellow e Vivaldi, nuk e penguan marshimin osman. Krejt gadishullit të madh ballkanik, bashkë me gjuhët, me kujtimet antike, me doket dhe kishat e tij, po i afrohej fundi. Në njërën nga betejat e fundit, gjatë rrethimit të qytetit shqiptar të Shkodrës, ushtarët turq, si britmë të sulmit përdorën fjalën “Romë! Romë!”. Perandoria po bëhej gati të mësynte Evropën dhe fraza e famshme e sulltan Mehmetit të Dytë se, do ta lidhte kalin e tij te porta e katedrales së Shën Pjetrit, i ngjethte mishtë kontinentit.

Ballkani pushoi së qeni pjesë e kontinentit evropian. Kështu, me një goditje të fatit, shqiptarët, si gjithë ballkanasit, humbën njëherësh lirinë, Evropën dhe, bashkë me të, poetin e parë të saj, Danten.

Dante Aligieri ka qenë dyfish i pamundur në këtë perandori të re: si i krishterë dhe si poet.


Është folur shumë për kinse tolerancën e pazakontë të perandorisë osmane. Siç ndodh shpesh në botën tonë, një gjysmë e vërtetë, duke kafshuar

vetveten, ka mëtuar të bëhet e vërtetë, domethënë të përfundojë në gjysmë gënjeshtëri.

Kështu ka ndodhur në Ballkan. Është marrë për tolerancë ajo që nuk ka qenë veçse një mënyrë veprimi e kushtëzuar nga logjika e një perandorie shumëkombëshe. Çdo shtet i tillë i stërmadh, i përbërë nga shumë popuj, raca, gjuhë dhe besime, donte apo s'donte, e kishte një pranim të "tjetrit". Ndërkaq, harrohet se është gjithmonë një pjesë që pranohet, kurse tjetra, ajo më e rrezikshmja, kurrësi. Te ballkanasit e mposhtur, pjesa më e rrezikshme u quajt gjuha e shkruar, kështu që pikërisht ajo u shtyp me mënyrat më mizore. Me mijëra ishin mësuesit dhe nxënësit që, në bodrumet e fshehta ku kapeshin duke mësuar shkrimin e gjuhëve të tyre, u masakruan mizorisht. Evropianët, që qëllon të shfaqin habi për kultin e gjuhës në Ballkan, do të ishin më të mirëkuptueshëm po të njiheshin me këtë martirizim të pashembullt.

Dante Aligieri mund të lejohej si i krishterë në trojet e Ballkanit, por jo si shkrimtar. Thënë ndryshe, mund të gjendeshin kisha, por jo shkronja për të.

Me botën myslimane ai ka vetëm një përkitje, për fat të keq, të gabuar. Është, me sa duket, i vetmi gabim i tij, në atë përg madhështor. Në rrethin e tetë të Ferrit, të dy së bashku, Dantja me Virgjilin,



takojnë profetin e myslimanëve, Muhametin. Skena ka një mister që nuk kapet lehtë. Profeti i fesë tjetër e pyet Virgjilin për Danten: “Ç’është ky?” dhe Virgjili përgjigjet: “Ende s’ka vdekur, unë i vdekuri i prij në Ferr, që krejt përvojën t’ia jap.”

Dantja nuk thotë asnjë fjalë të keqe për Muhametin, por vetë vendosja e profetit në rrethin e tetë është e pakuptueshme. Ai, që ndër gjithë poetët është i pari për depërtimin në largësi të vështrimit parashikues, nuk e kapi dot që një tercinë e vetme mund t’i krijonte problem në një miliard myslimanët e ardhshëm.

Misteri i skenës zbulohet po të përqendrohesh në të. Virgjili me Muhametin japin përshtypjen e dy të njohurve të vjetër, që e trajtojnë Danten si një rishtar. Vetë pyetja e Muhametit: “Ç’është ky?”, vetë përgjigjja e Virgjilit se është dikush që ende s’ka vdekur, dhe të cilit, Virgjili, mjeshtri, e njëkohësisht i vdekuri, po i mëson përvojat, vetë heshtja e Dantes dhe qëndrimi modest i tij përpara këtyre dy të regjurve të Ferrit, e theksojnë atmosferën disi të çuditshme.

Virgjili, mjeshtri, është njëlloj i pandjeshëm si ndaj myslimanizmit, ashtu dhe ndaj krishtërit. Ai ka parë poetët e vjetër, mjeshttrat e tij, me në krye Homerin, në fillimet e Ferrit e nuk ka thënë asgjë. Muhameti natyrisht nuk e kupton përse

ndodhet në atë rreth të errët, dhe pyetja e tij për Danten: “Ç’është ky?”, mund të tingëllojë edhe: “Ç’është ky që më ka vënë mua këtu?” (Thënë ndryshe, duke iu bindur logjikës së ëndrrës, pyetja e plotë do të ishte: “Ç’është ky poet që më përfytyron mua këtu, në këtë hulli, është në vete ky djalosh?”) Fjalët e Virgjilit se ai, Virgjili, është duke i dhënë djaloshit “përvojën e plotë” (per dar lui esperienza piena), mund të merren si njëfarë pranimi i tërthortë i habisë së tjetrit, profetit të fyer.

Kjo qetësi e skenës, kjo ngrirje, atje ku zakonisht gjithçka shfryn e shtillet si stuhi e zezë, a mund të merret si një qortim i artit mbi paragjykimet e një doktrine zotëruese, apo neve, njerëzve të sotëm, na pëlqen ta marrim kështu, ngaqë jetojmë në epokën kur po kërkohet me çdo kusht pajtimi midis feve?

Sidoqoftë, qasja nëpërmjet shtegut të poezisë është më e sigurta për çdo poet, dhe Dantja në këtë pikë nuk bën përjashtim. Ka qenë pikërisht rrethi i tetë, ku ai është ngatërruar disi edhe me Uliksin, i cili, po ta linin flakët e zjarrit të fliste, do të ankohej gjithashtu se shumë dënim të rëndë i kanë dhënë, për shkak të atij Kalit të Drunjtë të Trojës...

Është fare pak e besueshme që qoftë edhe një zyrtar i vetëm i shtetit osman të ketë lexuar Danten, e aq më pak të jetë shqetësuar për atë “tercinën e keqe”. Mungesa e shkronjave, atyre që do ta sillnin Danten në gjuhët e ballkanasve, do të ishte pengesa më e sigurt kundër tij.

Kur kjo pengesë ra, bashkë me rrëzimin e perandorisë, nisi edhe historia e vërtetë e Dantes me popujt e Ballkanit. Në këtë histori, kapitulli i shqiptarëve do të ishte ndoshta më i habitshmi.

E shkëputura e fundit nga perandoria, Shqipëria, pati një kronikë kaotike, dramatike e disa herë groteske. Malli për Evropën e munguar

pesë shekuj bëri që t'i dukej e natyrshme që, mbreti i saj i parë në liri, të ishte një princ gjerman, Vilhelm Vid. Lufta e Parë Botërore e zuri me këtë princ, por stuhia e saj, jo vetëm që do ta fshinte mbretërinë e përkorë por do ta kthente vendin në një teatër të vërtetë, kur ushtritë evropiane, aq shumë të munguara, si për të fituar kohën e humbur, shpërthyen po aq rrëmujsëm saqë kurrkush nuk u besonte syve. Ishin aty francezët, austriakët, grekët, italianët, serbët, bandat turkoshake e, natyrisht, ushtria shqiptare e komanduar nga holandezët. Në mbarim të stuhisë, të shumtë ishin shqiptarët që kujtonin se Shqipëria kishte rënë në humnerë, e po aq të shumtë ata që besonin të kundërtën, se Shqipëria ishte dyfishuar. Në të vërtetë kishte disa kryeqytete, qeveri, kantone, regjenca e principata, çka u mor, me sa duket, si vërtetim i zmadhimit. Kur retë u shpërndanë, u pa se Shqipëria as kishte rënë në humnerë e as ishte dyfishuar. Ajo thjesht ishte përgjysmuar.

Të mbetur me gjysmën e vendit (vetëm flamuri vazhdonte të ishte i plotë, me shkabën me dy krerë, si dikur), shqiptarët e mblodhën mendjen dhe e shpallën vendin republikë. Më pas erdhi mbretëria, këtë herë me mbret shqiptar, Zogun e Parë, por, më 7 prill 1939, ditën e së Premtes së zezë, si t'i kujtonte këtij vendi një mëkat ose një nostalgji të

vjetër, Italia e pushtoi atë.

Po atë prill, Shqipëria u bashkua me Italinë dhe mbreti i kësaj të fundit mori titullin zyrtar: Viktor Emanuel i Tretë, mbreti i Italisë dhe i Shqipërisë, perandor i Etiopisë. U duk sikur ëndrra e Shqipërisë së madhe, që ishte përhirë aty-këtu me tjetër emërtim, po kryhej, më në fund, por në trajtën e një makthi. Ndërsa kufijtë e mbretërisë së re po zgjeroheshin gjer në Afrikë, aty për aty Shqipëria tkurrej e bëhej kruspull.

Pasi u bënë me mbret italian, surpriza të mëdha po i prisnin shqiptarët. Ndërsa befasimin e parë, ndodhjen në një shtet me zezakët e Etiopisë, do ta merrnin për fyerje të racës së tyre, asaj që s'kishin reshtur ta himnizonin si më të fismen e Ballkanit, e papritura e dytë do të ishte e këndshme. Nën kurorën e përbashkët, Italia po sillte si prikë poetin e parë të saj: Dante Aligierin. Nuk ka hulumtime për të shpjeguar se si është ardhur te ky mendim. Me sa dukej, përderisa ishte fjala për diçka të rrallë e solemne, siç ishte një bashkim, një vënie kurore midis shtetesh, mendja, vetvetiu, përpara se të shkonte te muzika e piktura dhe thesaret e tjera të Italisë, do të ndalej te kryezoti i saj shpirtëror, tek themeluesi i vetë italishtes, te simboli i bashkimit, shkurt te poeti-princ, Dantja. Dhe kështu, Dante Aligieri, poeti hyjnor, profetik, kombëtar,

bashkues, zyrtar, i Italisë, u bë gjithashtu e, në njëfarë mënyre, poeti i parë zyrtar i shqiptarëve. Kështu, Shqipëria e vogël, ajo që e kishte humbur Danten, ashtu si ballkanasit e tjerë dikur, po e rifitonte befas, dhe çfarë rifitimi!

Tani e kishte të vetin, mund të krenohej me të, më fort se kushdo, të tundte portretin e tij me dafina përbri shenjave të ikonave të saj.

Propaganda italiane nuk mund të gjente makinë më çudibërëse për të joshur shqiptarët se sa ky personazh tronditës. Me dhjetëra ishin jo vetëm përkthimet, botimet e ribotimet e tij, por klubet, rrethet studimore, shoqatat, nismat, institutet bamirëse, konkurset e forumet, mbrëmjet gala, sheshet e rrugët, me emrin e Dante Aligierit. Gjithë Shqipëria ngjante si e stërpikur prej poetit.

Asnjëherë në histori nuk kishte ndodhur që një shtet pushtues në krye të autobлиндave e të armëve të tij të vinte poemën më të bukur të njerëzimit. Pak kohë më pas, gjermanëve nuk u shkoi mendja ta bënin këtë me Gëten a Bethovenin, ngaqë rrethanat ishin të ndryshme, apo ndoshta ngaqë, më shumë se tek ata, kishin besim tek “Panzerët” dhe “Luftvafen” e tyre.

Duke zbarkuar portretet e tij (portretet e tij të përziëra me flamurët ushtarakë, kuzhinat e topat fushorë), Italia e vuri princin e saj të poezisë në

skajimin më të bezdisshëm që mund të përfytyrohej. I gjendur befas midis rrebeshit, në një vend të vogël që ndoshta nuk ia kishte dëgjuar as emrin, ai, poeti i ndërgjegjes, ndëshkuesi i mëkatarëve, i cezarëve pushtues, i dhunuesve, i mashtruesve, duhej të ndihmonte popullin e vet italian të mbyste një tjetër popull. Dhe jo vetëm kaq, ta mbyste duke e përkëdhelur, duke i pëshpëritur në vesh: ti je në zemrën time (L'Albania é nel mio cuore - Musolini), ne jemi një familje tani, kemi një mbret dhe një... poet të parë...

Ishte një *gjendje*, po të përdorim një fjalë të vetë Dantes, aq shumë e ngjashme me Ferrin e krijuar prej atij vetë.

Koha do të tregonte se shqiptarët, zakonisht idhnakë e të sertë, nuk do të krijonin asnjë keqkuptim me poetin.

Që Dantja kishte lindur për të gjithë kjo ishte e lehtë të kapej. Por që kjo të kapej prej një populli ballkanas, mu midis luftës, kjo ishte vërtet një gjë e rrallë.

Kishte kohë që shqiptarët e donin, dhe koha prapë do të tregonte se shteti pushtues italian nuk mund t'i bënte dot ta donin më shumë, ashtu siç nuk do t'i bënte ta donin më pak.

Sipas Ernest Koliqit, danteolog dhe shkrimtar shqiptar antikomunist, i ikur nga Shqipëria fill pas kapitullimit të Italisë, përkthimet e para të Dantes, copa nga "Komedia hyjnore", "Jeta e re" dhe "Gostia", u përkthyen e u botuan në shekullin e 19-të, nga arbëreshi Luigi Lorecchio. Në vitin 1900 u përkthye Kënga e pestë e Ferrit, nga Sokol Baçi, shqiptar erudit nga Mbishkodra. Ndër të parat përkthime, fill pas pavarësisë dhe kaosit shqiptar ka qenë Kënga e njëmbëdhjetë e Parajsës (Shën Françesku), prej Pater Vinçens Prenushit, poet e dijetar, vdekur tragjikisht më pas në burgjet

komuniste. Në vitet '30 ndodhi shpërthimi i Dantes me përkthime e përkthyes të shumtë, ndër të cilët u dallua vetë Ernest Koliqi.

Të shquar për mospërqendrim e për xanxën lër një punë e zër një tjetër, shqiptarët, me gjithë joshjen pas Dantes, nuk arritën megjithatë ta jepnin të plotë në shqip "Komedinë hyjnore". Të tria pjesët dhe të njëqind këngët e poemës madhështore, dukej sikur ishin krijuar enkas për natyrën e trazuar të bijve të shqipes. Përkthyesit rendnin nga njëra pjesë te tjetra e, si të mos mjaftonte kjo, edhe brenda së njëjtës pjesë nuk gjenin karar. Kështu, për shembull, brenda Ferrit, që merrej me mend se i ishin qepur shumica e tyre, kapërcenin nga një rreth në tjetrin, sipas gjendjes shpirtërore, mllfeve ose armiqësive të çastit, që terciinat danteske ua kujtonin aq bindshëm.

Ndryshe nga Shekspiri dhe Servantesi që gati në të njëjtën periudhë u bënë popullorë në Shqipëri, me kryevepra të plota si "Hamleti" e "Don Kishoti", gjeniu tjetër i Evropës po hynte në indet e jetës shqiptare, në një mënyrë fare të ndryshme, nëpërmjet copave, dromcave, motërzimeve, citimeve e komenteve të pafundme. S'mund të thuhej se ishte një qasje shembullore ndaj poetit, por po aq s'mund të thuhej e kundërta. Dantja po bëhej popullor pas një stili tjetër, më shumë i

palexuar se i lexuar, që ngjante çuditërisht me shpërndarjen e poezisë gojore. Kronika e ferrit dantesk i shtohet natyrshëm kronikës së zezë të gazetave shqiptare, aq të shumta në atë kohë dhe po aq të mbushura me ndodhi të ngjashme. Të paktë ishin përkthyesit që i aviteshin Purgatorit, e fare të rrallë ata të Parajsës, si rasti i Atë Vinçens Prenushit.

Është folur edhe më parë për ndjeshmërinë e veçantë të shqiptarëve për Hamletin, ngaqë u kujtonte gjakmarrjen e tyre, e po ashtu për Don Kishotin ngaqë në portretin e tij shihnin si në një pasqyrë lajthitjet e tyre të herëpashershme. Për Danten gjithashtu, qysh në krye u tha se i shkonte për shtat, madje më fort se dy të parët, trazimit shqiptar.

Në Romë, në qetësinë e trishtuar të mërgimit, Ernest Koliqi vazhdonte të merrej me këto afërsi. Shënimet që ka lënë, rrjedhë e njëfarë ankete me studentë shqiptarë e italianë, në Universitetin e Romës, ku jepte mësim, janë dyfish të çmuara. E para sepse janë tepër të holla e jashtë gjithë klisheve të studimeve për Danten, e dyta, sepse, duke qenë përsiatjet e një të dëbuar, ashtu si fiorentinasi i madh, ato përshkohen nga ai filli i njohur kërthizak, që e bashkon nganjëherë përkthyesin me mjeshtrin.

Ernest Koliqi shkruan se mendësia dhe natyra

pasionante e poezisë danteske ishin lehtësisht të kapshme për shqiptarët, ngaqë jo vetëm ngjarjet e kohës së poetit fiorentin ishin të ngjashme me katrahurën shqiptare, por krejt lëmshi i pasioneve e i ambicieve pa fre, ndarjet në klane, shpërthimet e dhunshme, intrigat e kacafytjet mes fisesh e familjesh të mëdha, së fundi përndjekjet dhe dëbimet e pamëshirshme, të kujtonin çuditërisht ato të kohës së poetit.

Në shënimet e tij, Koliqi përmend se, falë gjurmëve që kishin lënë në kujtesën shqiptare, tri perandoritë, romakja, bizantinia e sidomos otomania, ishte e lehtë për studentët shqiptarë të Romës të kapnin përvijimin (konceptin) historiko-politik dantesk. Grindjet midis pushtetit perandorak me kryezotët vendas, ishin tepër të ngjashme në Italinë e kohës së Dantes, me ato të feudalëve trillanë shqiptarë, që i kundërviheshin sulltanit. (Sipas Koliqit, ndërsa e kapnin fare mirë këtë, studentët e kishin vështirë të kuptonin acarimet perandor-papë, ngaqë kronikat e perandorisë otomane nuk jepnin asnjë rast analogjie, domethënë përçarjeje midis pushtetit sulltanor dhe atij fetar.)

Ka gjasë që në leksionet e Romës të jenë cekur prej Koliqit afërsi të tjera, jo vetëm midis dantizmit dhe psikës së shqetësuar shqiptare, por edhe në rrafsh poetik. Koliqi i njihte mirë baladat e moçme

shqiptare të krijuara disa qysh nga koha e Dantes, në të cilat këto afërsi duken që larg. Bota e përtejme, rrugëtimi nëpër të, hyrjet dhe daljet që andej të personazheve, vajtjet atje të bujtësve të gjallë, e kthimit që andej të të vdekurve e kështu me radhë. Sidomos këta të fundit janë më të shpeshtët: të vdekur që vijnë me leje triditëshe, ose njëjavëshe, për të kryer një punë të lënë përgjysmë, kryesisht një premtim (m'ka zënë vorri o me besë të dhanë) etj., etj.

Jo më pak e ngjashme është bota e amaneteve, e porosive, e kumteve dhe lajmeve të dërguara me anë zogjsh, resh a qyqesh, nga trevat e vdekjes në ato të jetës ose e kundërta. Ashtu si "Komedia hyjnore", baladat ballkanase janë të mbushura me të tilla. O ju korba që më hani. O ti erë, o ju re. Bëni këtë e bëni atë. M'i çoni falmeshëndet nënës. Ose, m'ia ktheni unazën nuses. Në fushë të Rmait kur të shkosh, kërcoma varrin. Në pyettë nëna për mua, i thoni kështu ose ashtu etj., etj.

Banorët e ferrit dantesk janë po ashtu plot kujtime e derte të tilla. E kanë mendjen mbi tokë, duan të dinë ç'bëhet atje lart. Dhe as brengat dhe as pezmi nuk u del.

Këto ahte e kjo rropamë ngjan aq fort me një botë tjetër, atë të mërgimit. Dantja e ka njohur, por jo në përmasat e frikshme që do të merrte më pas

kjo dukuri. Amerika, më i madhi shesh i mërgimit botëror, ende nuk ishte zbuluar. Por Dantja pothuajse e kishte dhënë ndërkaq atë tablo madhërisht të trishtuar që Evropa e tërë, duke përfshirë italianët vetë, e pas saj gjithë bota, do ta përjetonte. Ballkanasit, e sidomos grekët e shqiptarët, sipas zakonit të vjetër, do të krijonin baladat më mallëngjyese për këtë “kurbet të ri” që, në të vërtetë, ishte një gjysmëvdekje, ngaqë më shumë se gjysma e atyre që iknin nuk ktheheshin më.

Askund tjetër në rrëfimin botëror, trevat e mërgimit nuk ngjajnë aq fort në thelbin e tyre, me trevat e ferrit e të purgatorit, siç i ka dhënë Dantja. Banorët e Ferrit të tij janë çuditërisht të afërt me mërgimtarët, madje edhe me ata të sotmit. Dromcat e rrëfimeve, brengat, zemërimet, kureshtia politike e të dy palëve, etja për lajme, amanetet, pengjet e mbetura, duken si të dala nga i njëjti brumë e nga i njëjti popull. Madje ngjashmëria shkon gjer në atë shkallë saqë po të sajnin një ndërthurje të tyre, lexuesi i sotëm do ta kishte vështirë të dallonte, në një lexim të parë tekstin e Dantes nga modele kronikash a reportazhesh të sotme.

Ç'bëhet në Romë, ka luftë a paqe? Durrachio ish nisja, në Otranto u mbytëm. Kujtohu dhe për mua që jam nga Pia. Siena më bëri dhe më zhbëri

Marena. Për mue ndiz një qiri te Fushë e Rmait. Shpirtin e dhashë me emrin e Marisë. Bëra kaq letra s'm'u përgjigj askush, gjersa kamioni i internimit erdhi. Ç'ndodh në Tiranë, kush i fitoi zgjedhjet? Guelfët a Gibelinët?

Ky zhumhur qyteti, këto emra rrugësh, adresa, porosira, djerrina ku ka dalë shpirti, nëma, polemika, guva ku frymojnë metrotë e ardhshme, bashkë me grafititë e tyre, gjithë kjo atmosferë prej megapoli është kaq tunduese për vetë Danten sa që ai vetë, kur ndesh në Ferr dikë nga Firencia, nuk rri dot pa e pyetur mos e ka njohur rastësisht një grua të re me emrin Beatrice Portinari?

Skena është befasuese. Poeti, krenar që ka dhënë fjalën se nuk do ta përmendë më Beatricen e vdekur, gjersa të mund të shkruante për të "ashtu si për asnjë grua në botë s'ishte shkruar", papritur ka etje të flasë për të qoftë edhe me një endacak të skëterrës. Dhe jo vetëm kaq. I pamëshirshëm me veten, i duhet të durojë shpërfilljen e tjetrit, i cili tund kryet në mënyrë mohuese, për të treguar se ajo që për poetin ishte, ndërkaq, qendra e gjithësisë, për endacakun s'ishte kurrkushi.

Me atmosferën e rrugës, Dantja, pas një mijë e shtatëqind vjetësh ndërprerjeje, i rikthen letërsisë botërore rropamën madhështore të tragjedisë greke. Ndryshimi ishte se, ndërsa në teatrin antik

polifoninë e krijonte kori, në poemën danteske ajo dilte nga ahti i popullsisë së pafundme të të vdekurve.

Mund të thuhet se ai ishte i pari që arriti të kapte zhurmat e ardhshme të qyteteve të botës. Ishin ato që do të sillnin qytetërimin, atë qytetërim që niste pikërisht te thellësitë e Ferrit, thënë ndryshe, te mundimet e ndërgjegjes.

Pyetja nëse ishte “italishtja vulgare” që e barti me vete rrugën në botën danteske, apo ishte rruga ajo që i kushtëzoi poetit italishten e saj, ka gjasë të ketë mbetur ende e pandriçuar mirë. Sidoqoftë, dukuria është madhërisht e vetmuar në historinë e njerëzimit: një gjuhë që, në lindjen e parë të saj, jep poemën e cilësuar “hyjnore” e që, pas saj, nuk besohet se do të japë një të dytë.

Përpara se të kishte nga një histori me çdo popull të botës, është e natyrshme që historinë e parë, atë më të befasueshmen, Dantja do ta kishte me popullin e vet, më saktë, me italishten. Historia e Dantes me të mund të përmbliidhet në pak radhë. Një popull dhe një njeri i vetëm bashkëpunojnë për të krijuar diçka të veçantë: një katedrale, një qiell dehës, një tmerr a një mëshirë të madhe si dikur. Dhe kështu, ata të dy, italishtja dhe Dantja (Shën Mëria, ende vajzushkë dhe Fryma e Shenjtë) e lindën atë mrekulli.

Të tjera njohje do të vinin pastaj. Të tjera gjuhë... Me secilën prej tyre poeti do të kishte një histori. Një histori mirëkuptimi, keqkuptimi, herë më fort e herë më pak të stuhishme, si gjithë historitë e dashurisë.

Shënimet për kalimin e Dantes në gjuhën shqipe janë vrojtimitet e fundit të Ernest Koliqit. Mendimin e tij se Dantja është gjuhësisht i afërt për shqiptarët, ai e mbështet me një mendim të Gjergj Fishtës, që gjithashtu i ka njohur “të tri gjendjet”, por kryengulthi: adhurimin për dyzet vjet në Shqipëri, mallkimin për dyzet vjet të tjera, e tani ringjalljen në Shqipërinë e sotme. Gjergj Fishta, sipas kujtimeve të Koliqit, mendonte se gjuha shqipe, “gjuha jonë mashkullore”, sipas tij, ishte tepër e përshtatshme për të mbartur shprehjet krenare danteske.

Për fat të keq, Fishta nuk ka dhënë shpjegime të mëtejshme. E as Koliqi.

Në shënimet e tij për Danten, Ernest Koliqi nuk e përmend asnjëherë një ngjashmëri tjetër: atë të kampeve naziste të përqendrimit, si dhe të gulagut komunist, me botën danteske. Në çastet e para, kur këto tmerre u zbuluan, në gojët ende të mpira nga lemeria, ishte pikërisht fjala “danteske”, që vinte e para.

Shënimet e Koliqit janë të viteve '70, kohë në të cilën gjithçka ishte bërë e njohur. Në vështrim të parë, kjo mungesë ngjan e habitshme. Madje po aq e habitshme duket diçka tjetër. Duket se Koliqi ka humbur rastin që, qoftë edhe kalimthi, të

përmendë brengën e tij prej të dëbuari politik, atë brengë që e lidhte atë, përkthyesin dhe idhujtarin, me idhullin e vet.

Ajo që në pamje të parë ngjan e habitshme, në një tjetër shfaqet e shpjegueshme. Ernest Koliqi ka një lidhje me fashizmin italian. Në vitet '30, ai ka qenë një shkrimtar shqiptar i shquar fashist. Në vitet '40 gjithashtu. Në veprën e tij letrare nuk ka asgjë fashiste, madje asnjë gjurmë simpatie për Italinë e kohës. Kurse në jetë është ndryshe. Pas bashkimit të Shqipërisë me Italinë, ka pranuar postin e ministrit të Kulturës, në qeverinë kuislinge shqiptare.

Nuk ka dhënë asnjëherë shpjegime për këtë zgjedhje tragjike. Me sa duket, një keqkuptim i rëndë për të ardhmen evropiane të Shqipërisë e ka çuar drejt Romës. Ndryshe nga shkrimtarët kombëtaristë shqiptarë, një pjesë e të cilëve miq të tij, që himnizonin një Shqipëri të veçuar, puritane e jashtë rrjedhave të kohës, ai ishte ithtar i një Shqipërie moderne. Mendësia italiane, e mbështetur nga kujtimet historike të lidhjes së ngushtë të Shqipërisë me Venedikun, Romën e Vatikanin, lidhje të ndërprera prej pushtimit osman, i është dukur atij, si shkrimtar katolik që ishte, e vetmja mundësi e Shqipërisë për t'u rikthyer në Evropën e krishterë.

S'është vështirë të merret me mend se ç'do t'i punonin komunistët shqiptarë Ernest Koliqit po ta kishin kapur. Nuk është vështirë të përfytyrohet ndëshkimi, aq më tepër kur një tjetër poet, me të njëjtin mëkat si ai, me të njëjtën nofkë "tradhtar", nuk i shpëtoi dot kapjes. Ky ishte amerikanë Ezra Paund, i famshëm si rrallëkush, mik i Xhojsit, i T. S. Eliotit e i shumë të mëdhenjve.

Natyrisht, që të kapeshe prej komunistëve shqiptarë ishte krejtësisht tjetër gjë se sa të kapeshe prej amerikanëve. E, megjithatë, këta të fundit ishin treguar të pamëshirshëm me Paundin. As fama, as miqësitë, as naiviteti i tij i njohur, nuk e ndihmuan dot shkrimtarin. I mbyllur në kafaz si bishë e egër, nën dritën e një projektori, që s'fikej kurrë, nën përqeshjet e kalimtarëve, ai që për shumicën e studiuesve quhej poeti më i madh i gjuhës angleze në shekullin e 20-të, do të përjetonte atë që ia kalonte çdo makthi.

Pas stuhisë, Ezra Paundi dhe Ernest Koliqi, dy poetët e dëbuar nga vendet e tyre, njëri i shquar në atdheun e tij të madh, e tjetri në të voglin, njëri, ai më i famshmi, ish-spiker i Radio Romës, tjetri, më pak i famshmi, ish-ministër, përfunduan të dy në vendin ku kishte zënë fill e keqja e tyre: në Italinë postfashiste. Koliqi në Romë, Paundi në Rapallo, në veri.

Ka shumë pak gjasë që Ezra Paundi ta ketë njohur Koliqin, aq sa është jashtë çdo dyshimi që ish-ministri ta ketë njohur, madje adhuruar poetin e madh. Tani janë të dy të vetmuar, por, veç gjërave të trishtuara që bashkojnë mërguesit, ata kanë një shenjë të epërme që i lidh: Dante Aligierin.

Të dy merren me të, ashtu siç janë marrë gjithë jetën, madje tani më fort se kurrë. Dantja s'është vetëm sivëllai i tyre i madh. Ai është kisha e tyre, këndi i rrëfimit, shëlbimi i madh.

Koliqi është po aq i lidhur me mjeshttrin sa ç'ka qenë në adoleshencë, më pas në djalëri e pastaj në mjerim. Ezra Paundi, gati gjithë jetën, me "Canto"-t e famshme të tij, është përpjekur të ngrejë një kullë binjake me "Komedinë hyjnore". I mbyllur në kafazin e tmerrshëm, është jashtë çdo dyshimi që mendimi për Ferrin nuk i është ndarë kurrë. Ai kafaz, që më shumë se çdo gjëje i ngjante rrethojës së ndërgjegjes, dukej si i ndërtuar prej Dantes.

Janë marrë të dy me idhullin e tyre gjer në mbarim të jetës, por as njëri as tjetri nuk kanë folur për ferrin e tyre. Madje Ezra Paundi, në sprovat e tij për Danten, jo vetëm përpiqet, aq sa mundet t'i largohet ferrit, por rreket t'ia mbushë mendjen vetes dhe të tjerëve se, në kundërshtim me mendimin e përgjithshëm, pjesa e tretë e poemës danteske, Parajsa, është ndoshta më e bukura...

Është vështirë të besohet se pas kalimit nëpër purgator, ata të dy kanë pritur të shfaqen shenjat e parajsës. Por që e kanë ëndërruar, kjo merret me mend.

Që nga Verona, Dante Aligieri i ka bërë disa herë lutje Firences t'ia heqë dënimin e ta lejojë të kthehet. Lutja e tij nuk u dëgjua kurrë. Për Ezra Paundin herë pas here u bënë lutje nga shkrimtarët e mëdhenj të botës, që Amerika ta zbuste zemrën. As kjo nuk ndodhi.

Për Ernest Koliqin fati u tregua edhe më mizor. As u dëgjua kurrë e as mund të mendohej kurrë që nga Shqipëria të vinte një lutje mëshire për të. Shqipëria kishte mallkuar vetveten ndaj dhe mëshirë, edhe po të donte, s'nxirrte dot.

Ndërkaq, për një habi, që shpesh ndodh me shkrimtarët, mallkimet kundër Koliqit, ashtu si kundër Fishtës, ashtu si kundër të tjerëve, nuk zinin vend. Me sa dukej, shqiptarët ishin mësuar me to ngaqë shpeshherë edhe vetë shkrimtarë të njohur të kohës komuniste, për “gabime ideologjike”, me lehtësinë më të madhe cilësoheshin si “dekadentë, reaksionarë, antisocialistë, antipopullorë, antiparti” etj., etj. Krijohesh përshtypja se këto cilësime, bashkë me vështirësitë, i krijojnë shkrimtarit njëfarë hijeje e nderimi të fshehtë.

Kishte, megjithatë, një arsye më tepër që damka

e tradhtarit mos të zinte vend mbi Koliqin. Në kohën që kishte qenë ministër i Kulturës në qeverinë fashiste, ai kishte hapur shkollat shqipe në Kosovë. Siç është thënë më lart, shkollat shqipe, në viset ku gjuha shqipe kishte qenë e ndaluar, quheshin për shqiptarët po aq të shenjta sa tempujt fetarë. Rrjedhimisht, hapja e tyre ngjante me një mision të shenjtë.

Mjaftonte kjo pamje e dyzuar e tij që Ernest Koliqi, krejt si personazhet e Purgatorit, të ndodhej në një gjendje shëlbimi, pra, midis mallkimit dhe bekimit.

Kjo ishte, me sa dukej, arsyeja që balanca e gjykimit të tij, qysh ditën e parë pas rënies së komunizmit, anoi në favor të tij. Ernest Koliqi u rehabilitua.

Pikërisht rehabilitimin, këtë ëndërr e këtë makth që duhet ta ketë ndjekur në të tridhjetë vitet e mërgimit të tij, ai e ka përshkruar në dramën e pikëllueshme "Rrënjët lëvizin". Ka bërë dy parashikime në të: vdekjen e tij në mërgim dhe rënien e regjimit komunist, të dyja aty nga mesi i viteve '70. Nga dy profecitë, u krye vetëm e para, vdekja e tij, kurse e dyta, do të vononte pesëmbëdhjetë vjet.

Ajo çka është befasuese në këtë dramë është atmosfera disi e çuditshme që zotëron. Ndonëse

është e dielë dhe kambanat e kishës së madhe katolike të Shkodrës, pas kaq vitesh heshtimi po bien përsëri, ndonëse regjimi ka rënë dhe njerëzit, ndër të tjera, e kujtojnë me mallëngjim shkrimtarin e mërguar, që nuk e mbërriti dot këtë ditë, ngazëllimi i lirisë, ashtu dhe rehabilitimi i shkrimtarit kryhen në një atmosferë tepër të përmbajtur, për të mos thënë të ftohtë. Në këtë kah, nga të gjitha leximet që mund t'i bëhen dramës, ka gjasë që njëri prej tyre të jetë jashtë çdo dyshimi: kjo është drama e shkruar prej një banori të Purgatorit, atje ku, ashtu siç vuajtja është pa dhimbje, ngadhënjimi po ashtu, është pa hare.

Në të vërtetë, kur komunizmi ra në Shqipëri, jeta u tregua më zemërgjerë se vetë Ernest Koliqi ndaj vetes së vet. Rehabilitimi i tij ishte i menjëhershëm dhe pa kurrfarë mëdyshjeje. Vite me radhë, stinë pas stinë e javë pas jave, Koliqi ka ndjekur ngjarjet e Shqipërisë komuniste. E dinte mirë ç'ndodhte atje. Shumë prej miqve e njerëzve të fisit i kishte në burgje, të tjerët në kampe pune, e një pjesë nën dhé, me nga një plumb mbas qafe. Shkruante herë pas here për terrorin e pashembullt. Merrte pjesë në mbledhjet e Penklubit të Evropës. Në qetësinë e Romës ndiqte, ndër të tjera, fatin e idhullit të vet: Dante Aligierit.

E mban mend mirë atë që i ka ndodhur në ato

ditë të paharrueshme, fill pas kapitullimit të Italisë. Gjithçka binte, shkërmoqej, përpiquej të ikte. Shkuleshin shenjat e perandorisë së prishur, rrëzoheshin emblemat, tabelat e pafundme, midis të cilave, ato që mbanin emrin e Dantes. Mijëra ushtarë italianë të mbetur pa zot, vërtiteshin si endacakë katundeve dhe qyteteve të Shqipërisë. Ishin ata që pyesnin tani: A ka ndonjë lajm nga Roma? Jam nga Firencia, në Tepelenë lashë krahun. Do të vij në anijet, apo këtu do të vdesim?

Dy kërcënime u vareshin mbi krye: nga njëra anë trupat gjermane që vinin si re e zezë nga kufiri grek, dhe që i pushkatonin ish-aleatët e tyre si dezertorë, nga ana tjetër, hakmarrja e famshme shqiptare. Ndërsa e para, ashtu siç pritej, përhapi tmerr, sidomos javët e para, e dyta u shfaq në një trajtë disi të habitshme: fisnike për disa, cinike për të tjerët. Shqiptarët nuk i prekën ish-pushtuesit: ata thjesht e kthyen pjesën më të madhe në shërbyes. Ishte kjo një shfaqje e bujarisë, një poshtërim meskin, apo një ngadhënjim i racizmit të tyre të njohur, ushtruar më parë kundër të gjithëve, grekëve, sllavëve, romëve dhe vetë italianëve? Shumë shpejt ata do të binin vetë viktimat të racizmit, por, të shquar për kujtesë jo fort të gjatë historike, pothuajse asnjëherë s'do të kujtoheshin se po paguanin mëkate të vjetra.

Që nga trualli i mërgimit, ku është vendosur tashmë, ashtu si ai që, midis pështjellimit të katastrofës nuk ua ndan sytë ca shenjave të njohura, Ernest Koliqi ndjek kronikën shqiptare. Është pothuajse i bindur se, bashkë me tabelat “Shoqata Dante Aligieri”, “Miqte e Dantes”, bashkë me vetë gjuhën italiane, që po shkulej gjithkund, për t’ia lënë vendin rusishtes, stuhia do ta merrte me vete poetin. Ndërkaq, për një habi të madhe, kjo nuk po ndodhte.

Kjo nuk po ndodhte as më pas kur, pas ikjes së gjermanëve, komunistët e vendosën, më në fund, diktaturën. Në gjithë këtë stuhi, Dantja ishte i vetmi që kishte mbetur në këmbë. Dhe jo vetëm kaq: ai vazhdonte të përkthehej. Dhe jo vetëm kaq, por mu midis komunizmit shqiptar, rendit më të egër, më të pafe e më të huaj për Danten, vepra e poetit po përkthehej më e plotë dhe më mjeshtërisht se kurrë!

Në pamje të parë gjithkujt do t’i dukej një paradoks. Por nisur nga një kushtëzim sipëran, dukuria do të dukej më se e logjikshme: Dante Aligieri do të përkthehej më i plotë, më natyrshëm, më mallëngjyeshëm, më shenjtërisht, pikërisht brenda njërës prej të tri gjendjeve të tij, asaj të ferrit.

Ai kishte lindur për të gjithë... Por, ndërkaq, ishte një zonë e gjerë e botës, perandoria e trishtuar komuniste, ku popuj të tërë, të rrëzuar në gjunjë e

pa shpresë, kishin nevojë për të. Kishin nevojë shqiptarët, që e patën për ca kohë poet të tyre të parë, po aq sa hungarezët, rusët, hebrenjtë, sllovakët, çekët, polonezët, baltikasit, ukrainasit, rumunët, gjeorgjianët, armenët, sllavët e jugut.

Në vetminë e mërgimit, Ernest Koliqi e ka marrë vesh këtë lajm të madh. Ai ka marrë vesh madje emrin e përkthyesit, Pashko Gjeçi, që, si vetë Koliqi, ishte katolik nga Shkodra. Kishte qenë në burgjet komuniste, pastaj në punë të detyruar në zhegun e gurores, së fundi i liruar, dhe askush nuk e dinte se me cilën nga këto “tri gjendje”, kishte kryer përkthimin më madhështor në shqip të “Komedisë hyjnore”.

E gjithë kjo, e sidomos botimi i përkthimit, i duket Koliqit, më e pabesueshme se një ëndërr, dhe më e brishtë se një shajni. Kishte ndodhur një mrekulli në vendin e mëkatit e të krimit, atje ku kryqi ishte rrëzuar në pluhur, atje ku s’kishte mëshirë e as ndjesë për kurrkënd.

“Komedia hyjnore” ishte vepra më e huaj për atë botë. I vetmi ungjill i mbetur dhe e vetmja ndërgjegje e vrarë.

Si çdo ëndërr, mrekullia e Dante Aligierit në Shqipëri, shoqërohet me frikën e fikjes. Me sa duket, është kjo drojë, drojë se mos magjia priset, arsyeja që Koliqi nuk e përmend ngjashmërinë e

rrezikshme. Një kujtesë, një denoncim i dikujt, një trill i diktatorit, dhe Dante Aligierit do t'i humbte Shqipërisë edhe për gjysmë shekulli. Më e keqja e të gjithave do t'i humbte pikërisht atëherë kur Shqipëria, më shumë se kurrë, kishte nevojë për të.

Ka një orë të Dantes, ashtu siç ka një orë të pasdites, të agut apo të muzgut. Një orë të takimit me të, drejt së cilës shkojnë popuj, rende, epoka, mbretërira, republika, raca, kombe e gjuhë të ndryshme. Rrebeshet e planetit tonë mund ta shtyjnë atë orë, por kurrësi nuk mund ta ndalin.

Në fillim të viteve '40 të shekullit që porsa shkoi, Dante Aligieri, pasi fitoi, në rrethana gjysmë dramatike e gjysmë groteske, një atdhe të dytë, u gjend, falë këtij të fundit, në kufi me një vend që e njihte fort mirë: Greqinë.

Ndonëse Greqia ishte çliruar e para nga

perandoria osmane, takimi me të, ashtu si me gjithë ballkanasit, ishte i vonuar. Më 1966, poeti Jorgo Seferis ankohet që ende s'ka në greqisht një përkthim siç duhet të "Komedisë hyjnore".

Më 1939, pas bashkimit të Shqipërisë me Italinë, kufiri i vjetër greko-shqiptar, ishte kthyer në greko-italo-shqiptar. Greqia u gjend kështu ngjitur me mbretërinë fashiste, që jo vetëm valëvitte në erë shenjat e moçme perandorake të Romës, por shpallte kërcënueshëm ringjalljen e saj. E, ringjallja e Romës do të thoshte para së gjithash, ripushtim i Ballkanit. E, natyrisht, i Greqisë.

Përndezja kishte pushtuar ndërkaq dy kryeqytetet, Romën dhe Tiranën. Shqipëria e vogël, ende pa e marrë veten nga ai që disa e quanin pushtim e disa bashkim me Italinë, mezi po ndërgjegjësohej se ndodhej midis një aventure të re. Nëpër mejhanet, njëlloj si në ballot me maska, dialogët delirantë nuk reshtnin. Me ç'dukej, s'paskësh qenë rastësi, por një shenjë hyjnore, që qyteti antik i Butrintit, ku trojanët, stërgjyshërit e romakëve, kishin bërë ndalesën e tyre të parë, gjatë rrugëtimit në Itali, ndodhej pikërisht në Shqipëri. Vetë Musolini ndiqte hap pas hapi gjërmimet dhe, ndonëse emri i arkeologut italian, Ugolini, të kujtonte një banor të bezdisshëm të ferrit dantesk, kjo nuk e pengonte ngazëllimin.

Kishte ardhur ora e hakmarrjes për Trojën!
(Katërqind vjet më parë, disa ditë pas pushtimit të
Kostandinopolit, thuhej se sulltani i turqve,
Mehmeti II, në fjalimin e tij të parë programatik,
kishte deklaruar se më në fund ishte kryer
hakmarrja kundër grekëve, prej nipave të trojanëve,
thënë ndryshe teukrëve, me gjasme *turqve!!!...*)

Trojës po i dëlnin stërnipa gjithkund, dhe merrej
me mend se shqiptarët, të shquar si hakmarrës, nuk
do të linin t'u shpëtonte ky rast.

Përgatitjet për luftë vazhdonin. Një mjegull
rrinte pezull ndërkaq mbi të. Ç'luftë do të ishte kjo?
Midis Italisë dhe Greqisë? Midis mbretërisë së
bashkuar italo-shqiptare kundër mbretërisë greke?
Apo thjesht midis dy deshëve të vjetër të Ballkanit,
Greqisë dhe Shqipërisë? Në kafenetë plot tym të
të dy vendeve, njerëzit e thjeshtë besonin më fort
këtë të fundit.

Në Tiranë, ca ethe të vjetra po shfaqeshin
përsëri. Pas bashkimit me Italinë, Shqipëria e kishte
marrë prapë Kosovën. Dukej e natyrshme që, pas
luftës me Greqinë, të merrte krahinën tjetër,
brengën e saj të Jugut, Çamërinë. Duke shtuar
sëpatat e Liktorit sipër flamurit të vet, Shqipëria
po zgjerohej, thoshin disa. Të tjerë ngulmonin për
të kundërtën: Shqipëria po tretej.

Ndërkaq, në shtyp po vërshonin kujtimet

nostalgjike për Ali Pashë Tepelenën, tiranin shqiptar që kishte sunduar për 40 vjet Greqinë Veriore. Racizmi i njohur antigrek ishte në këmbë. Pezme të vjetra, histori të qena e të paqena pabesish zhbiroheshin arkivash: mosmiratimi prej parlamentit grek i gjuhës shqipe si gjuhë e dytë e vendit, akte të tjera si ky etj., etj.

Muzika e luftës po bëhej shurdhuese matanë Adriatikut. Në kabinetin e tij në Romë, Benito Musolini shfletonte parashtrimet e fundit për vjegën e luftës. Në zyrën e tij ministrore në Tiranë, Ernest Koliqi i hidhte një sy të fundit projektit të librit të leximit për shkollat e para shqipe në Çamëri. Gishti i Benito Musolinit ndalet mbi fjalën “vrasje”. Për mendësinë ballkanase një vrasje ishte më bindëse se gjithçka. Me dorën e tij ai shton përbri “vrasje e pabesë e një shqiptari”.

S’kalojnë as dyzet e tetë orë dhe radiot e Tiranës e të Romës, bashkë me gazetatat, natyrisht, nuk flasin veç për këtë. Në një katund përbri kufirit grekët kanë vrarë pabesisht një shqiptar.

Të dy kryeqytetet e mbretërisë dyshe kërcëllijnë dhëmbët. Emri kërcënues “Tiranë”, i kryeqytetit shqiptar, dukej si i sajuar enkas për gjendje të tilla. Pas radios e gazetave janë kafenetë që ndizen. Do të ketë luftë se s’bën.

Ashtu si më 1920-ën, si më 1914-ën, në

Sarajevë. Po në Sarajevë, ishte një princ trashëgimtar që u vra, duka Franz Ferdinand, në mosgabo, kurse ky këtu... Do të thuash se ky s'qenkësh veç një katundar? Po harrove se ai është në radhë të parë shqiptar? Dhe gjaku i shqiptarit nuk falet kurrë, këtë e di gjithë bota.

Vala e krenarisë për gjakun që s'falet në katërqind breza, siç e ka saktësuar kodi i lashtë, pushton mendjet gjithkund. Në kujtesë sillen histori të vjetra. Kujtohet, madje botohet në shtyp, replika jo fort e besueshme e kryepeshkopit shqiptar me ambasadorin kinez në Lidhjen e Kombeve, kur ky i fundit, i habitur nga zhurma e madhe që bënte numri i paktë i shqiptarëve, kishte thënë: "Po kaq njerëz në Kinë mbyten çdo vit nga lumi", hirësi, dhe përgjigjja e famshme e peshkopit: "Mos harroni shkëlqesi, se këta janë shqiptarë e jo kinezë".

Racizmi antikinez ka gjasë të bëhet i modës, sikur të mos ketë të tjera punë të ngutshme. Dhe ngut e mbi ngut, është gjakmarrja. Është vlarë një shqiptar! Kjo britmë tingëllon fundbotshëm, thua se është hera e parë që një gjë e tillë ndodh. Harrohet aty për aty se bijtë e shqipes, ndonëse mbahen për burra tepër të rëndë e me qokë, vriten për shkaqet më të rëndomta në botë. Për një fjalë të pakujdesshme në kafene. Për ngacmim të qenit,

(pale pastaj të gruas). Për një mijë marrëzira të pabesueshme.

Tani të gjithë janë bindur për të kundërtën. Është vrarë një shqiptar! Le ta marrë vesh bota mbarë, se kur vritet një shqiptar bëhet hataja!

Dhe hataja ndodh vërtet. Domethënë lufta.

Më 28 tetor 1940, trupat e mbretërisë italo-shqiptare kapërcejnë kufirin. Në të vërtetë, janë disa regjimente italiane dhe veç një batalion shqiptar, "Tomorri".

Një i vetëm, vërtet. Por ama batalion shqiptar!

Dante Aligieri, më i madhi poet i Evropës, ai që u quajt “model i përjetshëm” nga dikush, e Homer i krishterë nga të tjerët, mbërrinte, pra, në rrethana të pazakonshme, në portat e Greqisë.

Po a mund ta priste Greqia triumfalisht, ashtu si fqinji i saj verior e trillan, Shqipëria? A mund të përsëritej historia e botimeve luksoze, e klubeve, e forumeve, e shoqatave, e konkurseve, e gala-ve, së fundi e qindra vajzave të vogla të pagëzuara me emrin “Beatrice”, për shkak të Beatrice Portinarit të tij? Në fund të fundit, a kishte nevojë Greqia për një tjetër Homer, qoftë edhe të krishterë?

Të gjitha gjasat ishin jo dhe jo. Greqia kishte poetët e saj të mëdhenj, kështu që s'kishte pse të mahnitej pas Dantes. Veç kësaj, një shpërfillje e këtij të fundit ndaj greqicitetit, fryt i edukimit zyrtar që i trajtonte grekët si masakruet të trojanëve, stërgjyshërve të romakëve, nuk kishte si të mos ishte vënë re. Dhe atë rrethin e parë të ferrit ku me njëfarë lehtësie, të përligjur kinse prej mos-pagëzimit, ishin vënë poetët grekë me në krye Homerin, mund t'ia kujtonin pak, këtij sinjore Aligierit.

Jo, Dante Aligieri nuk kishte shans në Greqi. Ai nuk mund të kishte asnjë shans sidomos pas kësaj lufte. Mbretëria italo-shqiptare mund ta fitonte luftën, por poeti i parë i saj, do të thyhej me siguri. Madje mund të thuhej, se ndryshe nga ç'ndodhi në Shqipëri, ku pas kapitullimit të Italisë, i vetmi fitimtar ishte Dante, në Greqi, në të gjitha rrethanat ai nuk mund të ishte veçse humbës.

Dihet si përfunduan ethet e vjeshtës së vitit 1940. Përndezjet e ëndrrat perandorake patën si epilog kufirin shqiptaro-grek të shndërruar në një baltak të madh, ku gropat, telat me gjemba dhe topat e përmbysur, ishin bërë njësh me kufoma mushkash e djemsh të rinj.

Dy poetët grekë më të mëdhenj të kohës, Jorgo Seferis dhe Odisea Elitis, u gjendën në vorbullën e

kësaj lufte. I pari, konsull në qytetin shqiptar të Korçës, jo vetëm i ka përjetuar tronditshëm ethet e luftës, por me siguri ka përpiluar raporte të fshehta për to. I dyti, oficer i ushtrisë greke ka marrë pjesë në kundërsulmin dhe pastaj marshimin brenda tokës shqiptare, marshim nga i cili lindi “Axion esti”, kryevepra e tij.

Të dy poetët, nobelistë të mëvonshëm, e kanë parë tablonë e trishtueshme të kufirit shqiptaro-grek, atje ku te baltërat, llogoret dhe telat me gjemba, u duk se bashkë me ushtarët kishte ngecur edhe poeti i ferrit, Dantja. Ndërkaq, më i vjetri ndër dy poetët grekë, Seferis, në një homazh të bukur, për Danten, flet për një kufi tjetër, atë të gjuhës. Është një kufi i fshehtë dhe ashtu, të fshehta e të padukshme i ka pengesat e telat me gjemba të tij. Ka gjasë që në këtë kufi, më shumë se në atë tjetrin, të dukshmin, të ketë ngecur Dante Aligieri.

Jorgo Seferis, rrëfen brengën e tij që, për shkak të mosdijes së italishtes, e njohu aq vonë (“në mes të jetës sonë”, siç shkruan me elegancë), poetin e madh fiorentin. Kjo brengë na shtyn të ndërmendohemi për një histori të dytë të Dante Aligierit, një kronikë tjetër të marshimit të tij të pashmangshëm planetar, atë që ndodh përtej qeverive, institucioneve, doktrinave e pushtimeve. Kjo histori e dytë që ndodh në një hapësirë tjetër,

atë të gjuhëve, është ndoshta më e ndërlikuar se e para, dromca të së cilës i pamë më lart. Është kështu, sepse i tillë, i mistershëm e plot enigma është universi i gjuhës.

Në fillim ishte italishtja... Pa asnjë dyshim, ajo dhe përherë ajo. E, megjithatë, nuk do të ishte gabim po të thuhej: në fillim ishin të dy, italishtja me Danten.

Vështirë se do të mund të ketë ndonjë tjetër poet që do të mund të krijonte marrëdhënie të tilla me gjuhën. T'i quash edipiane, ngaqë Dantja ishte bir e njëkohësisht atë i saj, është ende e pamjaftueshme. Ato ishin më të ndërlikuara se kaq. E, pa dyshim, më nismëtare e më të mistershme.

Herë-herë krijohet përshtypja se historia e tij me italishten përkitet me enigmën tjetër, atë të

Beatriçes. Përkitja është, pa dyshim, e mjegullt, e parrokshme gjer në fund, ashtu si gjithë enigmat e mëdha. Herë-herë duket sikur atë që ai nuk e bëri dot me Beatrice Portinarin e kreu me gjuhën italiane. Ashtu si një vajzuke, që nëpërmjet dashurisë dhe pllenimit, shndërrohet në grua të re, ashtu dhe italishtja, mbetur për herë të parë shtatzënë me poetin, lindi “Komedinë hyjnore”, pjellën e vetme, të pangjashme me asgjë tjetër në këto shtatëqind e pesëdhjetë vjet.

Ngjashmëria me botën e dashurisë bëhet edhe më e dukshme, po të kujtojmë latinishten, zonjën e rëndë, të braktisur prej poetit për hir të vajzukes së rrugës. Qortimet që i bëhen për këtë, së fundi ftohtësia e herëpashershme e së dashurës, e çojnë më larg analogjinë.

Kështu është puna me italishten. Kurse aventura e Dantes me dhjetëra gjuhët e tjera të botës, është, pa dyshim, më e mjegullta, e më pak e dëshmuara. Është kështu, ngaqë nuk mund të jetë veçse i errët e i parrëfyeshëm rrugëtimi i këtij makthi hyjnor në trajtë poeme nga njëra gjuhë në tjetrën. E kemi gati të pamundur të përfytyrojmë afrimin e poemës ndaj një gjuhe të huaj, turbullirën që shkaktohet që larg nga prania e saj, mundimet e gjuhës strehuese për ta thithur (birësuar) atë, ndryshimet që përpiqet t’i bëjë poemës, e sidomos

ndryshimet që vetë gjuha strehuese pëson prej mysafires së rrezikshme.

Duke vrarë mendjen për marrëdhëniet e Dantes me gjuhët e botës, nuk ka se si t'i shmangemi pyetjes: ç'gjuhë përdoret në trimbretërinë e tij? Ajo duhet të jetë e tillë që të mundësojë bisedat e banorëve që vijnë nga shekuj dhe popuj të ndryshëm, të qenë e të paqenë kurrë. Me atë gjuhë ata merren vesh mes veti për gjithçka a ndoshta për asgjë. Në këtë kah, ajo që për ne quhet "përkthim", në rastin e poemës së Dantes, mund të merret edhe si njëmendësim, si një rizbërthim i një lënde të dendësuar e të bërë njësh prej më të bukurës katastrofë të poezisë. Së fundi, ajo mund të merret si një kërkesë, një lutje e këtyre shpirttrave për t'u shprehur në gjuhën e tyre. Shkurt, diçka e pashmangshme si Dantja vetë.

Pothuajse njëzëri ithtarët e tij ngulin këmbë se që ta kuptosh vërtet Danten duhet të dish italishten. Madje disa shtojnë se duhet të dish italishten e Firences.

Ndër këta të fundit ishte edhe Jorgo Seferis.

Në vitet '30, kur Seferis ishte konsull në qytetin shqiptar të Korçës, një nga ato qytetet provinciale që mendjelehtësisht mëtonin të ishin "Parisi i vogël", e që, sado qesharakë të dukeshin, nuk mungonin kurrë në Ballkan, në Korçën dimërore,

pra, përveç dëborës e ngricave kontinentale, që u duk se ndryshuan temperaturën në poezinë e tij, poeti ka gjasë të jetë habitur më shumë nga diçka tjetër. Në ballot “alla pariziane”, poeti, që e kishte ende përpara lavdinë, do të jetë shtrënguar, madje jo pa njëfarë smire, kur ka vënë re lehtësinë me të cilën zonjat vanitoze e disi tyryfyle nga mendja, citonin në një italishte gati të përkryer vargje të Dantes. Ai vetë, ndonëse e kuptonte sivëllaun e vet gjenial një mijë herë më thellë se ato, s’do të guxonte ta bënte këtë.

Me sa duket, këtu nuk jemi në një rastësi, e aq më pak në një ngjarje groteske të radhës, nga ato që gëlojnë në gadishull. Jemi më tepër në një nga ato skutat e errëta të asaj gjithësie që u quajt pak më lart misterioze, e që është bota e gjuhëve. Është fjala për një raport tejet të çuditshëm midis dy gjuhëve: italishtes dhe shqipes. Është folur e vazhdon të flitet përherë e më tepër për të, por ende sot nuk ka asnjë shpjegim për enigmën kryesore. Dhe enigma është kjo: janë dy gjuhë që duket se s’kanë asgjë të përbashkët: italishtja dhe shqipja. Ndërkaq, ndërsa shqiptarët vetvetishëm e pa ndonjë përgatitje, e kuptojnë mirë a keq italishten, italianët nuk kuptojnë asgjë nga gjuha shqipe. Një tekst shqip në sytë e tyre është po aq i errët sa edhe një tekst hungarisht ose norvegjisht. Kurse për

shqiptarët është e kundërta.

Dhe kjo ndodh me të gjithë: me hamejtë, akademikët, horrat, garazhistët, bankierët, murgeshat apo zuskat. Kjo ka ndodhur në të gjitha regjimet: në republikë, në fillim mbretërie, në fund të saj, në fashizëm, në komunizëm, në post-komunizëm. Kjo ka ndodhur kur TV italian nuk dukej në Shqipëri, madje kur TV ende nuk ishte shpikur. Së fundi, kjo ka qenë njëlloj si në kohën kur shqiptarët ishin racistë ndaj italianëve, si atëherë kur rolet u ndërruan dhe këta të fundit u bënë racistë ndaj shqiptarëve.

Misteri i një raporti të tillë midis dy gjuhëve të kujton qelqet ose pasqyrat e shtrigave, kur njëra palë sheh mes për mes tyre e tjetra nuk dallon asgjë.

Ky mister gjuhësor na ndihmon ndoshta të kuptojmë, në rastin ballkanik, se ashtu si telat me gjemba të kufirit nuk mund ta pengonin Danten më shumë se gjuha greke, ashtu edhe kurora mbretërore italo-shqiptare e të gjitha traktatet e tjera s'mund ta afronin Danten, nëse gjuha shqipe do të ishte shtytëse ndaj tij.

Ashtu siç pritej, kishte ndodhur e kundërta. Ashtu si në historitë kundërthënëse të dashurisë, mund të thuhet se, sido që të zhvilloheshin marrëdhëniet italo-shqiptare, gjuha shqipe do të merrej vesh gjithsesi me Danten. Parashikimi i

Fishtës dhe Koliqit se Dantja i shkonte shumë edhe shpirtit shqiptar edhe gjuhës shqipe, u vërtetua, madje u kapërcye dukshëm.

Mijëra shqiptarët e vegjël nëpër shkolla, duke shfletuar tekstet dygjuhëshe, kalonin natyrshëm nga vargjet e përkthyer shqip në ato italisht. Nganjëherë krijohej përshtypja se ishte e njëjta gjuhë, veç me maska të ndryshme në fytyrë.

*Quivi perdei la vista e la parola,
Nel nome di Maria fini', e quivi
Caddi, e rimase la mia carne sola.*

*(Dhe humba mend e gojë, ngadalë tue u
mekun,
shpirtin e dhashë me emnin e Marisë,
ku rashë unë mbeta vetëm mish i vdekun.)*

Kënga 5, Purgatori

Është një strofë e përkthyer pak a shumë lirshëm, në kohën kur ka me qindra vargje që tingëllojnë si dy origjinale:

*e caddi come un corpo morte cade
(dhe rashë ashtu si trup i vdekur bie)*

Kënga 6, Ferri

Tundimi për të përkthyer Danten ishte i tillë, saqë edhe një shkrimtar komunist, madje drejtues i lartë i Lidhjes së Shkrimtarëve, Mark Ndoja, i braktisi poemat sovjetike për t'u marrë me Danten. Përktheu Ferrin dhe Purgatorin, ndërkaq përfundoi në burg, pa u marrë vesh, nëse ishte Dantja që e çoi drejt burgut apo burgu drejt Dantes.

Autori i këtyre radhëve, në moshën 13-14-vjeçare, ashtu si mijëra shkollarët e tjerë, u gjend përpara kësaj përballjeje gjuhësore të çuditshme, që e vinte çdo tru të njomë në një trazim ëmbëlsisht të rrezikshëm. Ishin dy këngë që më së shumti gjendeshin kudo, në libra leximi, në revista, madje dhe në gazeta: ajo e Paolos e Françeskës, dashnorët tragjikë, që s'gjenin qetësi midis stuhisë së rrethit të dytë të ferrit, dhe ajo e Kont Ugolinit, banorit të rrethit të nëntë, atij që nga uria hëngri fëmijët e vet. Në atë kohë, fëmijët shqiptarë as i dinin as mund t'i dinin hamendjet e mëvonshme për misterin e turbullt të kësaj kënge. Ajo që mungon në mizërinë e hamendjeve, nëse Konti Ugolini i hëngri apo jo fëmijët e vet në "kullën e urisë", apo e gjithë skena nuk është veçse tundim i errët, vegulli a trandje e mendjes, shkaktuar nga uria, ajo që mungon, pra, është një zbërthim i tekstit sipas vizionit të fëmijëve. Borges, që ka shkruar një nga sprovat më të bukura për Danten, pikërisht fjalët e

fëmijëve, që i luten të atit “t’i zhveshë prej mishit me të cilin i kishte veshur”, me fjalë të tjera t’i hajë, i gjen si një notë të rreme në vepër. Por Borgesit, i cili e adhuron Danten dhe, ashtu si ai, gabon rrallë, nuk do t’i dukej ndoshta retorike shpallja e fëmijëve, nëse do ta kishte lexuar këngën e famshme në kushtet e fëmijëve shqiptarë. Për fëmijët, të hahen prej diçkaje ose prej dikujt, është një rrezik më se i rëndomtë, një frikë e përditshme që trashëgohet, me sa duket, bashkë me atavizmat e tjera. Kështu që të hahen prej të atit të vet, për ta nuk është kurrësi aq e lemerishme sa për të mëdhenjtë.

U soll ky shembull për të marrë me mend se si mrekullia e leximit të hershëm të Dantes nuk është gjithmonë e trëndafiltë.

Kurse dygjuhësia e tekstit, kalërimi, hedhja nga shpina e njëres gjuhë tek tjetra mund të shkaktojë gabime e incidente, që mund të lënë gjurmë në kohë. Por, në raste të shumta, gabimet janë gjithashtu të bukura. Gjithmonë autorit të këtyre radhëve, falë kuptimit të gabuar të vargut në italisht:

“Seguito ’l terzo spirito al secondo”
(Mbas të dytit zu të flasë një shpirt i tretë)

për një kohë të gjatë i ka zënë vend në kujtesë ideja, se në “Komedinë hyjnore”, ka, midis të tjerash, personazhe me dy, madje edhe me tre shpirtra. Besuar si një gjetje e admirueshme, nuk mund të shkaktonte veçse gënjim më pas, në rastin e një rileximi në shqip.

Si çdo histori, madje si çdo përrallë rrëfimtare, historia e shkurtër e Shqipërisë me Dante Aligierin do të kërkonte një mbyllje.

Për shkak të natyrës së saj, e sidomos për shkak të zhvillimit të saj në disa rrafshe, që, në këtë rast, të ndikuar siç jemi prej ngrehinës danteske, mund t'i quanim rrathë, mbyllja nuk është e lehtë.

Nëse do ta nisnim nga gjërat më të dukshme e njëherazi më të zhurmshme, mendja na shkon te lufta që pat buisur mu në mes të kësaj historie.

Gadishulli ballkanik është i dëgjuar për përfitim delirant të luftërave, kur kacafytjet e paqena

bëhen të qena, ose betejat e humbura besohen si të fituara. Në rastin e katrahurës ku Dantja u gjend i përzier, ajo, përveç tri emërtimeve të ndryshme, që u përmendën më lart, pati kohëzgjatje të ndryshme. Ndonëse u shpall luftë italo-shqiptarogreke, pjesa e saj me Italinë u quajt e mbaruar bashkë me Luftën e Dytë Botërore, kurse pjesa me Shqipërinë kurrsesi. Sado që ishte e pritshme që mllefet midis ballkanasve të ishin shumë më këmbëngulëse se me popujt e largët, gjithsesi nuk parashikohej që grotesku të shkonte aq larg, sa që ende sot, në verën e vitit 2005, në kohën që po shkruhen këto radhë, asgjë s'ka mbaruar, dhe Shqipëria me Greqinë vazhdojnë ende të jenë në gjendje lufte!

Shqipëria ndërkaq, pas pushtimit italian të vitit 1939, atij që i solli si pajë Danten, dhe që u quajt çlirim i vendit prej tiranisë së mbretit Zog, më 1943, u shkel prej gjermanëve, të cilët gjithashtu e quajtën marshimin e tyre si çlirim të vendit prej Italisë, e më 1944, ra nën zotërimin komunist, atij që natyrisht do të quhej përsëri çlirim.

Pas këtij seriali çlirimesh, Shqipëria do të përjetonte edhe një tjetër, me sa duket të fundit, më 1991-shin, këtë herë prej fatit.

Të gjitha epokat kërkojnë diçka që duket se nuk e kanë (a s'e kanë vërtet), njëfarë mbikohë, një pamje të epërme, thënë ndryshe, një shpirt.

Midis atyre që e mishërojnë këtë, e mbi të cilët qëllon të hidhet shpresa jonë, bën pjesë, pa dyshim, Dante Aligieri. Presim diçka tij. Të shëlbohemi, të ndreqemi, ose, ajo çka është më e mundshme, të vuajmë përpara pasqyrës që ai na vë përballë.

Mëtimi i Shqipërisë së vogël për të patur një histori të veçantë me Dante Aligierin, s'besoj se do të merrej si prirje përvetësimi, prirje aq fort e njohur në gadishull. Në fund të fundit të kesh një histori të privilegjuar me Danten, nuk është gjë tjetër veçse të ofrohesh për të vuajtur më fort.

Më lart u shtjelluan disa nga hatutë e kësaj dosjeje, të nismëtuara mbi një shekull më parë: ngjashmëritë e motiveve poetike e të pasioneve njerëzore, prirja gati sensuale e gjuhës shqipe për t'i thithur tercinat e poetit, më pas kurora e përbashkët dymbretërore dhe së fundi rendi i ri, ai që e bashkoi Shqipërinë me hapësirën komuniste.

Mbi këtë shtrirje të pafundme, nga Tirana në Murmansk e nga Berlini në Kamçatka, shumë herët u ndie ai shtërzim gjeografik, ajo përpjekje për një hartë të dytë, që po mbinte nga thellësia, sipas projektit të vjetër: atij të Dantes. Mendjet vizionare e dalluan të parët atë, që nga Kafka, Mandelshtami

gjer te Solzhenicini. Kolonitë ndëshkimore, rrethet saturnalë, arkipelagu i Gulagut, ishin disa nga spikamat e kësaj harte të re. Secili vend komunist sillte shenjat e veta. Në burgjet kineze, për shembull, në orën e edukimit brohoritjet për lavdinë e partisë komuniste, qëllonte që ishin më të zjarrra se ato të mitingjeve, jashtë mureve të burgut. Në shumicën e vendeve, hapësira brenda burgut dhe ajo jashtë tij, kishin prirjen të njëjtësoheshin, madje nganjëherë ishte vështirë të kuptohej se në cilën prej të dyjave, shpresa ishte fikur më keq. Në Rusinë sovjetike futeshin brenda të njëjtit varr i gjalli me të vdekurin. Në Çekosllovakinë, disi liberale, gjatë disa viteve u ndalua fjala “mirëmëngjes!”, për t’u zëvendësuar me “lavdi punës!”. Në këtë larmi kureshtare, si për të treguar se ishte një kohë kur e kishte patur të vetin Danten, Shqipëria do të gjendej më pranë tij.

Ishin varrezat e saj të burgjeve që ngjanin si të shestuara sipas modelit dantesk. Në këto varreza të trishtuara, dergjeshin të burgosurit që vdekja i kishte zënë gjatë dënimit. Sipas ligjeve shqiptare, këta të vdekur, përpara se të varroseshin si gjithë bota, duhej t’i plotësonin vitet e mbetura të dënimit nën tokë, në varrezën e burgut. Vetëm pas mbushjes së afatit familjarët kishin të drejtë të merrnin trupin. Ndërsa në ferrin dantesk shpirtrat vuanin

mëkatet e trupit, këtu ishin trupat që bartnin fajet e shpirtit. Për të burgosurit e përjetshëm kjo do të zgjatej në amëshim. Kurse për të pushkatuarit ishte edhe më keq: ata s'kishin varre. Jo vetëm të afërmit, por ishte llogaritur që as vetë pushkatuesit të mos e mbanin mend zallishten a rahun e shkretë ku e kishin sosur viktimën.

Dante Aligieri nuk ishte lidhur vetëm me tmerrnajën tonë. "Komedia hyjnore" e tij ishte, me sa dukej, e vetmja në botë, që rrezatonte po aq fuqishëm edhe zinë edhe dritën.

Pyetjes që Eugenio Montale, në kremtimin e Dantes, ia drejtoi vetes dhe të tjerëve: "Ç'kuptim ka për poetët e sotëm vepra e Dantes?", poetët e botës i janë përgjigjur e do t'i përgjigjen në mënyra të ndryshme, sipas "gjendjes" së tyre. Natyrisht që Dante Aligieri është gjithmonë Dante, por ka periudha kohe kur ai bëhet dyfish, trefish i tillë.

Kështu, në shekullin e 20-të, atëherë kur dukej se e kishte arritur majën më të lartë të lavdisë e se s'mund të rritej më, pikërisht atëherë në rrafshirën kolosale komuniste, nga Dante që ishte, ai u bë Dydantsh, Tridantsh.

Duke u rrëfyer rrugëtimin e tij të vetmuar në botën e të vdekurve, ai u tregoi sivëllezërve të vet

poetë, qofshin ata rusë, shqiptarë, baltikë a kinezë, se gjendja natyrale e shkrimtarit të madh është pikërisht ajo: të udhëtojë i gjallë midis vdekjes. Të pajeta shtrihen përpara tij mbretëritë, vrasësit, tiranët, orizoret, stuhitë, vetë ajri, që i prodhon ato. Përbindëshat dhe rreziqet janë rrotull tij, por ai ka një përparësi: ai është i gjallë, ndërkohë që ata s'janë. Ndaj fjalët e Virgjilit "mos u tremb, është një stuhi e vdekur", përbëjnë formulën e shpëtimit për shkrimtarin. Gjithë thelbi i "gjendjes", rrjedhimisht i fatit të tij, përmblihet në besimin ose jo ndaj kësaj formule.

Do të ishte e mangët mbyllja e bisedës për Danten, pa u kujtuar për Beatricën. Ai vetë ka dashur të jetë kështu, dhe i ka marrë të gjitha masat që të jetë vetëm kështu, ndaj ne s'na mbetet veç t'i përgjigjemi: u bëftë vullneti yt!

Është folur kaq shumë, e "si për asnjë tjetër grua", për të. Është hamendësuar se poemakatedrale e Dantes, ka gjasë të jetë shkruar në krye si një strehë për Beatrice Portinarin, ndaj dhe ndryshe nga çdo tjetër ngrehinë ajo ka nisur nga maja, nga Parajsa, për të zbritur më pas në pus. Vullneti i poetit ka qenë që ne ta mendojmë Beatricën prore në qiell, pranë Shën Mërisë. Ndërkaq, siç e pamë një herë, ai e kujton, madje kërkon lajme për të, mu në mes të Ferrit, kështu

kemi të drejtë që edhe këtë ta pranojmë si vullnet të tij.

Disa nga rrugët e Ravenës apo të Firences së sotme, ngjajnë me ato të dikurshmet, ato që i dhanë Dantes, bashkë me italishten vulgare, kronikën e tyre të përditshme. Nga ajo gjuhë e nga ajo zhurmëri, ai mbrujti poemën e vet hyjnore, ndaj, pavarësisht nga prishja e buzëve të nazikëve luksozë e, pa dyshim, të singertë të llojit Alfons Lamartin, ato rrugë e rrugina, bashkë me gjuhën, me dritat e zbehta, me shiun e me prostitutat e lagura prej tij, janë të pandara prej poetit.

Nisur nga kjo, përfytyrimi i një bisede të pasmesnatës, një bisede midis prostitutës dhe klientit të saj (një nga ata klientë që, pas dashurisë, bashkë me ndezjen e një cigareje, kanë qejf të ndërrojnë dy fjalë me vajzën), nuk do të ishte tepër i pabesueshëm. Nga theksi duket se je e huaj, nga ç'vend je? Nga... Shqipëria. Ah, ashtu? S'kam takuar ndonjëherë shqiptare. Si e ke emrin? Beatrice. Beatrice? Ka të tillë emra tek ju, apo e ke si nofkë të këtushme? Jo, s'është nofkë, është emri im i vërtetë, Beatrice. Në Shqipëri përdoret shpesh. Po a e di ti se me kë lidhet ky emër, tek ne italianët? Sigurisht e di, me Beatricën e Dantes. Aha, e ditke domethënë. Natyrisht që e di. E kam mësuar në shkollë...

Ky dialog i hamendësuar në mbarim të kësaj historie nuk ka patur për shtysë kurrresi ndonjë prirje poshtërimi a ironie për kurrkënd, për vajzat shqiptare, për burrat-klientë italianë, a për të dy palët bashkë. Aq më pak ai mëton të ketë ndonjë qasje simbolike ndaj figurës së Beatrice Portinarit, përpjekje për ta ulur atë nga kati i lartë i qiellit ku e ka vendosur poeti, ose për të zhbhiruar kinse natyrën e saj të dytë e të tjera trille si këto, aq shumë të njohura në kohën tonë. Beatriceja e parajsës danteske dhe ajo e rrugicës së errët të Milanos, nuk ndërhyjnë tek njëra-tjetra, ashtu siç nuk ndërhyjnë tek njëra-tjetra të dy Maritë e Krishtit, e para me dritën dhe e dyta me hijen e saj.

Beatricet e vogla shqiptare, ende të rralla në fillim të shekullit, e përherë e më të shpeshta në vitet '30, e sidomos në kohën e bashkimit me Italinë, janë rrjedhojë e tërthortë e përkitjes së Shqipërisë me Dante Aligierin. Emrat e tyre është vështirë të gjenden në librat e pagëzimit të kishave të gjora shqiptare, ngaqë shumica e tyre u rrënuan, por ato gjenden me shumicë në zyrat e gjendjes civile, atje ku janë njëlloj të shpeshtë midis të krishterkave e myslimankave.

Por kronika e tyre do të ishte e paplotë nëse nuk do të kërkoreshin gjithashtu në listat e policive të të dy vendeve, e sidomos në listat e atyre që u

mbytën gjatë përpjekjeve për të kaluar detin, e për t'u bërë prostituta në Itali.

Emrat e tyre qëllon që gjenden në pllakat e rralla memoriale, në skutat e bregdetit shqiptar, prej nga ku u nisën skafet që nuk arritën dot kurrkund: Beatrice Hysa. Beatrice Kodheli. Beatrice Marku. Beatrice Brahimi. Beatrice X...

Me këto pllaka të pikëllueshme, të gdhendura pa kujdes, e ku, përveç moshës të së vdekurës, gjendet aty-këtu ndonjë frazë përdëlllyese si: dritë të pastë shpirti atje ku je, në *paradiso*, mbyllet natyrshëm historia e shkurtër e Shqipërisë me Dante Aligierin.

*Pranverë - Paris,
verë - Mali i Robit (Durrës), 2005*